



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

Nr. 58 (A) 2023 i Regjistrimit Themeltar

Nr. 7 i Vendimit

V E N D I M

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Fiona Papajorgji, Anëtare
Sonila Bejtja, Anëtare

në datën 18.01.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 58 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ALEKSANDËR HAXHI, përfaqësuar nga avokat Shaban Nexhi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3773 (454), datë 12.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1, i Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së; nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për

**organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Aleksandër Haxhi (*kërkuesi*) është një ndër trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësve M. F. H., Gj. Xh. H. dhe R. M. H., në bazë të dëshmisë së trashëgimisë të lëshuar me vendimin nr. 993, datë 04.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Delvinë, me vendimin nr. 33, datë 21.04.1994, ka vendosur t’i konfirmojë të drejtën e pronësisë shtetases F. H. (Q.), bazuar në aktin e trashëgimisë nr. 98, datë 28.02.1994, për pronën e trashëguar nga babai i saj, për të gjithë pasurinë e trashëguar prej 200 m² truall, në natyrë, që është i lirë, së bashku me shtëpinë. Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekar, të lëshuar në datën 03.09.2001 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Sarandë, rezulton se ky vendim është regjistruar në regjistrin hipotekar të saj nr. 4, faqja nr. 57, nr. 172 indeksi, datë 25.10.1995.

3. Duke mos qenë dakord me vendimin nr. 33, datë 21.04.1994 të *KKKP*-së, Delvinë, kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt anulimin e tij dhe detyrimin e shtetases F. Q. të njohë si pronar të kësaj prone trashëgimtarët e Gj. H. dhe R. H.; detyrimin e *ZVRPP*-së, Sarandë të çregjistrojë pasurinë nr. 172, datë 25.10.1995 nga pronësia e të paditurës; marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë pranë *ZVRPP*-së, Sarandë për këtë pronë, duke qëndruar e bllokuar deri në përfundimin e gjykimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3552, datë 17.03.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 33, datë 14.04.1994 të *KKKP*-së, Delvinë në lidhje me kthimin në natyrë të truallit me sipërfaqe 200 m² dhe shtëpisë, të ndodhur në fshatin Tatzat, Delvinë; urdhërimin e *ZVRPP*-së, Sarandë të çregjistrojë nga pronësia e të paditurës F.Q. shtëpinë dhe truallin me sipërfaqe 200 m², të ndodhur në fshatin Tatzat, Delvinë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për kërkimet e tjera të saj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se vendimi i

KKKP-së, Delvinë nuk është nxjerrë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar, ndaj ky vendim duhej të anulohet pjesërisht vetëm për sa i përket kthimit në natyrë (fizik) të shtëpisë dhe truallit me sipërfaqe 200 m². Kundër këtij vendimi paditësja F. Q. dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) kanë paraqitur ankime.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1924, datë 15.09.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se prona e kërkuar nga e paditura F. Q. nuk është ajo që ka pretenduar, pasi, sikurse pranohet nga vetë e paditura, kjo pronë është ndryshuar në masën mbi 70%. Po kështu, edhe trualli që është pjesë funksionale e kësaj shtëpie është i pakthyeshëm. Në këto kushte, pala e paditur, AKKP-ja, nuk duhej të vendoste kthimin e pronës, por kompensimin e saj. Kundër këtij vendimi pala e paditur ka ushtruar rekurs.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3773 (454), datë 12.07.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me një tjetër trup gjykues, me arsyetimin se nga ana e kësaj gjykate nuk është kryer një hetim gjyqësor i plotë dhe i gjithanshëm, si dhe nuk është garantuar procesi i rregullt ligjor.

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 07.12.2023 me ankim kushtetues individual sipas objektit, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit përfundimtar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar çështjen në tejkalim të afatit të arsyeshëm, pasi rekursi është regjistruar në datën 25.11.2015, ndërkohë që vendimi i saj është shpallur në datën 12.07.2023, pra pas 8 vjetëve. Po kështu, kjo gjykatë ka shkelur afatin e arsyeshëm edhe për sa i përket zbardhjes së vendimit gjyqësor të arsyetuar, që ka

zgjatur më shumë se 4 muaj, duke cenuar, gjithashtu, edhe të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual.

8.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar asnjë nga parimet e pranuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Në arsyetimin e këtij kolegji nuk janë parashtruar argumente konkrete se përse akti i ekspertimit është i cenueshëm dhe nuk i përmbush kushtet për t’u konsideruar hetim i plotë dhe i gjithanshëm. Po kështu, ky kolegji ka vonuar zbardhjen e vendimit të arsytuar, duke mos respektuar parashikimet e neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës.

8.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së për vendimin e KKKP-së, Delvinë dhe formën e tij *quasi* gjyqësore. KKKP-ja, Delvinë nuk ka arritur të argumentojë se përse shtetasja F. Q. duhej të njihet si pronare e truallit, kur në bazë të të gjitha akteve të administruara nuk ekzistonin dokumentet e nevojshme për ta konsideruar atë si pronare. Ky kolegji nuk e ka marrë për bazë argumentimin e palës paditëse që ishte i bazuar në fakte dhe prova, në bazë të të cilit KKKP-ja, Delvinë ka marrë përsipër të kthente një pronë që nuk mund të kthehej, pasi nuk ishte e lirë dhe e pandryshuar dhe se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë arsytuar drejt bazuar në prova dhe në ligj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin

e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion. Ai përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më lart, Kolegji vëren se objekti i kërkesës në shqyrtim është kundërshtimi i vendimit nr. 00-2023-3773 (454), datë 12.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Përgjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit, pasi ka vlerësuar se nga ana e kësaj gjykate nuk është kryer një hetim gjyqësor i plotë dhe i gjithanshëm, si dhe nuk është garantuar procesi i rregullt ligjor, nuk mund të konsiderohet përfundimtar për qëllime të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për sa kohë që gjykimi i çështjes së kërkuarit është duke u gjykuar në gjykatat e faktit, Kolegji çmon se ai i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e tij ligjore të pretenduara të cenuara dhe më tej edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në kushtet kur kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 18.01.2024

A N Ë T A R E

/Sonila Bejtja/ (d.v.)

A N Ë T A R E

/Fiona Papajorgji/ (d.v.)

K R Y E T A R E

/Holta Zaçaj/ (d.v.)

Vërtetohet njësisht me origjinalin

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eugen PAPANDILE